

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjimshiti flet në prag të ndeshjes me San Marinon: Duket ndeshje e lehtë, por s'është e tillë, të jemi të përqendruar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/gjimshiti-flet-ne-prag-te-ndeshjes-me-san-marinon-duk-et-ndeshje-e-lehte-po-i589020
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:32:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5fa9b861b532c971c23e049e0a248384fc52922e78be74f0486af0d3803cd661
TEKSTI	bd198661d7f8766ce696bc56b51e912c214e1591348096ad601481d6dd42d39b
PAMJA	f3db6b40c4b40c62ab441da94e7591fa41f23e346a84a0c5a8bc57bf97e870f1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac8a1d6608366ba4c45bd3d5fbc0a407761fcc2ea0ca6a169075a81441ae65bd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac8a1d6608366ba4c45bd3d5fbc0a407761fcc2ea0ca6a169075a81441ae65bd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie Hungari/ Parlamenti i heq imunitetin kryeministrit Peter Magyar dhe dy ish-ministrave te Urbanit Komandanti i NATO-s: Rusia po rrit presionin mbi qeverite evropiane fundit

Gjimshiti flet në prag të ndeshjes me San Marinon: Duket ndeshje e lehtë, por s'është e tillë, të jemi të përqendruar



28 Shtator 2026, 19:40 Sport TEMA



Kombëtarja shqiptare e futbollit është gati për sfidën e dytë në fazën e grupeve të Ligës së Kombeve.

Pas startit me fitore ndaj Bjellorusisë, kuqezinjtë mbyllën përgatitjet në Tiranë paraditen e së hënës dhe pasdite udhëtuan drejt San Marinon. Në konferencën zyrtare për shtyp nga stadiumi pritës, përballë gazetarëve dolën tekniku kuqezi dhe kapiteni Berat Gjimshiti, të cilët analizuan gjendjen e skuadrës dhe objektivat për këtë transfertë.

Nuk është e lehtë, por përqendrimi duhet të jetë në maksimum. Shumica mendojnë se do të jetë një ndeshje e lehtë por nuk është e tillë, prandaj duhet të jemi maksimalisht të përqendruar. Nuk kemi pasur një periudhë të mirë, por u kthyem te loja e mirë. Synimet janë të forta duam vendin e parë, duhet të luajmë bashkë dhe të japim gjithçka në fushë-tha kapiteni Gjimshiti

Sipas Gjimshitit, Nations League është një kompeticion që jep shansin për kualifikimin për në Evropian.

Liga e Kombeve që na jep option për Europeanin. Hapi i parë ishte ky te ndeshja e fundit, që zhvilluam një ndeshje të mirë dhe fituam me meritë. Synimet janë të forta, duam vendin e parë dhe duhet të përmirësohet gjithë grupi që të luajë bashkë dhe të japë 100% për 90 minuta. Në këtë nivel, shumë shpejt ndryshon loja nëse gabon. Futemi në fushë me mentalitetin e duhur. Të jemi gati 100%. Varet si do luajë San Marino, por edhe më shumë si do luajmë ne. Me agresivitetin dhe kualitetin që kemi, do ia dalim bashkë. Duhen 11 lojtarë në fushë, ata nga pankina do jenë shumë të rëndësishëm nesër. Kjo duhet të jetë forca jonë nesër-shtoi Gjimshiti

Sa i përket situatës në grup, Shqipëria ndan kreun e tabelës me Finlandën me nga 3 pikë të plota, ndërsa Bjellorusia dhe San Marino mbeten pa pikë pas raundit të parë. Historiku i përballjeve flet tërësisht në favor të kuqezinjve: në 4 ndeshjet e zhvilluara mes tyre, Shqipëria numëron 4 fitore, me 13 gola të shënuar dhe asnjë të pësuar. Ndeshja luhet mbrëmjen e së martës, ku kombëtarja kërkon 3-pikëshin e radhës për të ruajtur ecurinë e plotë në grup.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Fitorja ndaj Bjellorusisë ngre moralin e Kombëtares” - Gazetari zbulon dy zgjedhjet e goditura nga Maran](#)

18:00 Sport

UEFA Nations League - Kombëtarja mbyll përgatitjet në "Shtëpinë e Futbollit" për ndeshjen ndaj San Marinos

14:10 Sport

[Gjermania, Schweinsteiger nuk i kursen kritikën: Kemi rënë në mediokritet. Klopp? Nuk është magjistari](#)

12:50 Sport / 4 komente

[Italia dhe frika për rënien në Ligën B, sa pikë duhen për ta evituar?](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.